

UDHËZUES

MBI PËRDORIMIN DHE TRAJTIMIN E SIGURT TË LËNGJEVE TË NDEZSHME

Ky Udhëzues u drejtohet punëdhënësve, menaxherëve dhe personave të tjerë brenda vendit të punës që kanë një përgjegjësi për shëndetin dhe sigurinë në punë.

Ky dokument duhet të përdoret si ndihmë për përdorimin dhe trajtimin e sigurt të lëngjeve të ndezshme.



Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve - Ministarstvo Finansija,

Rada i Trasfera - Ministry of Finance, Labour and Transfers

Inspektorati i Punës/ Inspektorata Rada/ Labour Inspectorate

PËRMBAJTJA

HYRJE.....	1
FUSHËVEPRIMI DHE QËLLIMI	1
ÇFARË ËSHTË NJË LËNG I NDEZSHËM?.....	2
SHKAQET E ZAKONSHME TË ZJARRIT DHE SHPËRTHIMIT.....	3
KONTROLLET, SIGURIA DHE MASAT E TJERA	4
FAQET E TË DHËNAVE TË E SIGURISË SË MATERIALIT (FDSM)	9
DEPONIMI I LICENCUAR	9
AUDITIMET	9
SHTOJCA	10



HYRJJE

Lëngjet e ndezshme janë të zakonshme në industrinë e tilla si prodhimi, ndërtimi, transporti, etj. Këto lëngje paraqesin rreziqe zjarri dhe shpërthimi në punë nëse nuk trajtohen dhe nuk ruhen në mënyrë të sigurt. Nga ju do të kërkohet t'u siguronit punëtorëve tuaj një nivel minimal sigurie në punë, ndërsa punoni me lëngje të ndezshme në përputhje me Ligjin e Kosovës 04/L-012 (Mbrojtja nga Zjarri) dhe Rregulloren Nr. 25/2012 (Për normat teknike të mbrojtjes nga zjarri në ndërtimin e impianteve për lëngjet e ndezshme, deponimin dhe toçitjen e tyre).

Incidentet në vendet e punës të cilat ndodhin si pasojë e lëngjeve të ndezshme/djegëse janë të një natyre serioze dhe kërkojnë vëmendjen tuaj. Ato jo vetëm që shkaktojnë lëndime serioze dhe vrasje të njerëzve, por gjithashtu dëmtojnë asetet dhe mjedisin, e që si pasojë detyroheni të mbyllni objektin industrial vetë ose nga ndëshkimi i autoriteteve rregullatore.



FUSHËVEPRIMI DHE QËLLIMI

Ky dokument udhëzues ka të bëjë me përcaktimin e lëngjeve të ndezshme, identifikimin e rreziqeve shoqëruese, ngritjen e vetëdijes, dhe sugjerimin e masave parandaluese dhe të kontrollit për ata që janë përgjegjës për përdorimin dhe trajtimin e sigurt të lëngjeve të ndezshme në aktivitetet e përgjithshme të punës, proceset e ndërtimit dhe spërkatjes.

Ky dokument bazohet në praktikatat më të mira të njohura ndërkombëtare në vendet e punës, me theks të veçantë në vendet e ndërtimit, ndërsa është në përputhje me Ligjin e Kosovës 04/L-012 (Mbrojtja nga Zjarri) dhe Rregulloren Nr. 25/2012 (Për normat teknike të mbrojtjes nga zjarri në ndërtimin e impianteve për lëngjet e ndezshme, deponimin dhe toçitjen e tyre).





ÇFARË ËSHTË NJË LËNG I NDEZSHËM?

Një lëng, pika e ndezjes e së të cilit është 600°C ose më pak, normalisht cilësohet si një lëng i ndezshëm. Trajtimi ose ruajtja e çdo lëngu të ndezshëm afër pikës së tij të ndezjes ose mbi të, nëse nuk menaxhohet në mënyrë të sigurt, shoqërohet me rreziqe zjarri dhe shpërthimi.

Pika e ndezjes

Një lëng mund të pësojë djegie kur ndizen avujt e ndezshëm që lirohen nga sipërfaqja e tij. Pika e ndezjes është temperatura në të cilën një lëng i ndezshëm lëshon avuj në përqendrim të mjaftueshëm për të formuar një përzierje të ndezshme me ajrin.

Një lëng i ndezshëm me një pikë ndezjeje nën temperaturën e ambientit do të jepë avull të mjaftueshëm për të formuar një përzierje të ndezshme. Lëngjet me një pikë ndezjeje më të madhe se temperatura e ambientit nuk kanë gjasa të formojnë përzierje të ndezshme nëse nuk nxehen, përzihen me materiale me pikë të ulët të ndezjes ose lëshohen nën presion si mjegull ose spërkatje.

Gjithashtu, lëngje të tilla ka të ngjarë të ndizen nëse janë të pranishme si një shtresë e hollë mbi një sipërfaqe, ose kur derdhen mbi materiale thithëse, të tilla si veshjet ose materialet e paketimit.

Sasia e avullit të ndezshëm që lirohet nga një lëng varet nga një sërë faktorësh, duke përfshirë temperaturën e lëngut, paqëndrueshmërinë e tij, sipërfaqen e lëngut të ekspozuar, kohëzgjatjen e ekspozimit dhe turbulencën e ajrit.



Kategoritë e lëngjeve të ndezshme

Kategoria 1: Pika e ndezjes <math>< 23^{\circ}\text{C}</math> dhe pika fillestare e vlimit $\leq 35^{\circ}\text{C}$.

Kategoria 2: Pika e ndezjes <math>< 23^{\circ}\text{C}</math> dhe pika fillestare e vlimit $> 35^{\circ}\text{C}$.

Shembuj të lëngjeve të ndezshme Kategoria 1 dhe Kategoria 2: Heksani, Toluena, Acetoni, Etanoli, Metanoli, Nafta, Benzina, Pentani, tretësi me PSV (Pika Speciale e Vlimit) etj.



Kategoria 3: Lëngje të ndezshme me pikë ndezjeje $\geq 23^{\circ}\text{C}$ dhe $\leq 60^{\circ}\text{C}$ [**Shembuj** C9 (tretës), Naftë, Aromaks (tretës), V.M.T (Vaj Mineral Terpentine), vajguri]; dhe lëngje të djegshme me një pikë ndezjeje mbi 60°C [Shembuj: Vaj furre dhe VNL (Vaj Naftë i Lehtë), vajra lubrifikues]



Përzierjet shpërthyesë dhe kufijtë e shpërthimit

Përzierja e ndezshme e avujve të ndezshëm me ajrin quhet përzierje shpërthyesë e cila mund të marrë flakë ose të shpërthejë në kushte të caktuara. Nëse merr flakë, flakët do të përhapen shpejt prej saj. Nëse kjo ndodh në një hapësirë të kufizuar (p.sh. brenda pajisjeve, kthinës, dhomës ose ndërtesës), përhapja e shpejtë e flakëve përmes përzierjeve shpërthyesë mund të rezultojë në një rritje të presionit dhe shpërthim pasues shkatërrues nga hapësira e mbyllur.

Kufijtë e shpërthimit i përcaktojnë përqendrimet (normalisht sipas vëllimit) të përzierjeve të ndezshme të avullit/ajrit që do të përhapin një flakë. Kufiri i Poshtëm i Shpërthimit (KPSH) / kufiri i ndezjes është përqendrimi minimal i avullit në ajër nën të cilin përhapja e një flake nuk do të ndodhë në prani të një burimi ndezjeje. Kufiri i Sipërm i Shpërthimit (KSSH) / kufiri i ndezjes është përqendrimi maksimal i avullit të ndezshëm në ajër mbi të cilin nuk do të ndodhë përhapja e një flake. Kufijtë e shpërthimit ndryshojnë për lëngje të ndryshme të ndezshme, nga zakonisht rreth 1% (KPSH) në 10 dhe 20% (KSSH).

Mjedisi fizik

Nëse avulli i ndezshëm i liruar është në gjendje të formojë një atmosferë shpërthyesë me ajër do të varet nga fakti nëse ai do të shpërndahet me ventilim natyror apo mekanik të ambientit të mbyllur, gjithashtu duke iu nënshtruar pengesave/bllokimeve. Nëse avujt e lëngshëm të ndezshëm janë më të rëndë se ajri, ato do të grumbullohen në zonat e poshtme si gropa, gryka dhe kullues. Nëse ndezja ndodh në vende të tilla më të ulëta, flaka ka të ngjarë të kthehet prapa deri te burimi i avujve, d.m.th. deri te lëngu i ndezshëm.

SHKAQET E ZAKONSHME TË ZJARRIT DHE SHPËRTHIMIT

Trekëndëshi i zjarrit - Që të krijohet një zjarr, Karburantet (lëngu i ndezshëm), Oksigjeni (ajri i ambientit) dhe Nxehtësia (burimet e ndezjes) duhet të jenë të gjitha të pranishme në proporcionin e duhur.

Shkaqet e zakonshme për fillimin e zjarrit pa dashje (incidentet) janë:

- Mungesa e trajnimit ose ndërgjegjësimi për vetitë e lëngjeve të ndezshme
- Kontrolli joadekuat i burimeve të mundshme të ndezjes
- Gabimet apo lëshimet procedurale
- Puna me nxehtësi me lëngje të ndezshme apo afër tyre
- Dështimi ose mosfunksionimi i pajisjeve
- Dizajni, instalimi ose mirëmbajtje joadekuate e pajisjeve
- Nxehtësia e tepërt e lëngut të ndezshëm, p.sh. mbi pikën e ndezjes
- Çmontimi ose asgjësimi i impianteve dhe pajisjeve që përmbajnë ose kanë përmbajtur lëng të ndezshëm
- Ekspozimi ndaj nxehtësisë së ndonjë zjarr në afërsi
- Përdorimi jo adekuat i tretësve për operacionet e pastrimit
- Keqpërdorimi i lëngjeve të ndezshme; për shembull, për të djegur mbeturinat.





Incidentet që përfshijnë lëngje të ndezshme ndodhin gjatë operacioneve të bartjes, duke përfshirë:

- Bartja nga depo dhe brenda lokaleve
- Kullimi dhe shpërndarja
- Aktivitetet e procesit, pajisjet e zbrazjes, përfshirë rezervuarët e karburantit të automjetit para mirëmbajtjes
- Asgjësimi dhe trajtimi i derdhjeve.

Lëngjet e ndezshme përdoren shpesh në proceset e spërkatjes dhe lyerjes në sektorin e ndërtimit. Spërkatja shpesh përdoret për lyerje brenda hapësirave të kufizuara (pajisje, dhoma, etj.). Një avull i dëmshëm i ndezshëm mund të formohet brenda pak minutash nga spërkatja dhe të shpërthejë për shkak të ndezjes.

KONTROLLET, SIGURIA DHE MASAT E TJERA

Nën-seksionet vijuese paraqesin kontrollet parandaluese, zbutjen, masat e sigurisë dhe reagimin ndaj emergjencave. Këto kontrolle mund të mbështeten me anë të kontributit të ofruar mbi Vlerësimin e Rrezikut nga punëtorët dhe mbikëqyrësit. Përdorni metoda të zbulimit dhe shtypjes për të shuar zjarrin.

Masat e Kontrollit Parandalues

Masat e kontrollit janë ato masa të cilat merren për të parandaluar një incident. Avujt e lëngshëm të ndezshëm lirohen për shkak të gabimeve njerëzore, dhe për këtë arsye duhet të keni masa parandaluese të kontrollit për të parandaluar ndezjen e tyre.

- **Eliminimi dhe zëvendësimi**

Përdorimi i lëngjeve me pikë të ulët të ndezjes duhet të shmanget kurdo që është e mundur. Kur lëngjet e ndezshme nuk mund të eliminohen ose zëvendësohen, atëherë duhet të përdoret vetëm sasia minimale e nevojshme për aktivitetin e synuar.

- **Përmbajtja**

Më mirë është që për lëngje të ndezshme të përdoren enë të mbyllura me gryka të kontrolluara sesa kontejnerë të lëvizshëm dhe të pakontrolluar apo rezervuar të hapur. Kjo redukton sasinë e lëngjeve që bien në kontakt me ajrin dhe zvogëlon rreziqet nga avujt e liruar. Gjithashtu, zvogëlon rrezikun e derdhjes. Vendet e punës kanë nevojë për një mjet për të përmbajtur derdhje, të tilla si një mur rrethues ose një prag mbrojtës.

Përndryshe, dyshemeja mund të projektohet për të kulluar në kanalet kulluese që çojnë në zonën e kontrolluar të grumbullimit. Gjatë zjarrit, kanalet e kullimit duhet të jenë të pajisura me detektor zjarri, alarmi dhe fikjeje.





- **Ventilimi**

Të gjitha zonat ku trajtohen lëngjet e ndezshme duhet të ajrosen në mënyrë adekuate për të holluar çdo avull të liruar në një nivel të sigurt (nën kufirin e tij të ndezshëm). Sistemet e ventilimit duhet të shkarkohen në një vend të sigurt.

- **Kontrolli i burimeve të mundshme të ndezjes**

Prioritet duhet të jetë parandalimi i rrjedhjeve dhe grumbullimi i mundshëm i sasive të rrezikshme të avujve të lëngshëm dhe të ndezshëm. Burimet e mundshme të ndezjes mund të jenë energjia p.sh. termike, elektrike, mekanike dhe kimike. Shembujt përfshijnë mjete ndërtimore të lëvizshme që operohen në mënyrë elektrike, që nuk përputhen me zonat e ndezshme; flaka e hapur, përfshirë pajisjet e saldimit dhe prerjes; pirja e duhanit dhe pajisjet e pirjes së duhanit; ndriçimi elektrik, qarqet dhe pajisjet e energjisë; pajisjet elektrike personale duke përfshirë telefonat mobil, kompjuterët dhe tabletët; impiant me fuqi mekanike; proceset që përfshijnë gjenerimin e shkëndijave; sipërfaqet e nxehta; elektriciteti statik dhe rrufeja.

- **Klasifikimi i zonës së rrezikshme**

Nëse vendi juaj i punës rregullisht ekspozohet ndaj avujve të ndezshëm si dyqanet e ngjyrave që përdorin tretës, duhet të zbatoni Klasifikimin e Zonave të Rrezikshme (KZRR). Brenda këtyre zonave të rrezikshme, vetëm pajisjet dhe sistemet mbrojtëse që janë të certifikuar nga ATEX mund të përdoren p.sh. pajisjet elektrike dhe instrumentet matëse.

Në rastet e identifikuar, merrni parasysh përdorimin e diagramit të zonës ose sinjalistikës që tregon qartë përmasën dhe natyrën e rrezikut në tre dimensionet.

- **Karikimi elektrostatik**

Duhet të merren masa parandaluese për të parandaluar ndezjen e avujve të ndezshëm nga shkarkimi i energjisë elektrike statike. Lëvizja e materialeve (të tilla si pluhurat) ose rrjedhja e avujve në tubacionet ose gjatë operacionit të pastrimit, gjithashtu mund të krijojnë rreziqe elektrostatike. Përdorni tokëzimin për ta shkarkuar në mënyrë të sigurt. Për të ditur më shumë rreth tij dhe si të kontrolloni ndezjet nga shkarkimet elektrostatike, ju lutemi referojuni “Udhëzuesit mbi energjinë elektrike në punë - Praktikat e Sigurta të Punës”.



- **Ngrohja e hapësirës**

Dhomat e punës në të cilat trajtohen lëngje të ndezshme preferohet të ngrohen me mjete indirekte, për shembull, radiatorë që ushqehen me tuba të ujit të nxehtë. Nëse nuk është e mundur, radiatorët me ngrohje elektrike duhet të jenë në përputhje me HAC.

- **Puna me nxehtësi**

Shkaku kryesor i incidenteve është puna me nxehtësi (saldimi, prerja ose operacione të ngjashme) të kryera në vendet e punës pranë zonave që përmbajnë avuj apo mbetje të lëngshme të ndezshme. Në atmosferë të ndjeshme me avull të ndezshëm, puna me nxehtësi duhet të bëhet vetëm nën Sistemin e Lejes për Punë (SLP), të autorizuar nga një person përgjegjës.



Konsideroni përdorimin e teknikave të prerjes së ftohtë si një alternativë e punës me nxehtësi, veçanërisht gjatë punës së demolimit, pasi ato mund të zvogëlojnë ndjeshëm rrezikun e zjarreve dhe shpërthimeve. Metodën e prerjes së ftohtë përfshijnë përdorimin e prerësve, turjelave dhe sharrave me energji hidraulike ose pneumatike, dalta pneumatike, prerës uji me presion të lartë. Me disa teknika të prerjes së ftohtë temperatura dhe mundësia e shkëndijave mund të reduktohen edhe më shumë duke aplikuar ujë ose lëngje të tjera jo të ndezshme në pikën e prerjes.

- **Pirja e duhanit**

Zonat e caktuara për pirjen e duhanit të përcaktuara dhe shënuara qartë, duhet të jenë në një vend të sigurt dhe jo afër vendit ku trajtohen lëngjet e ndezshme. Njoftimet që ndalojnë pirjen e duhanit dhe flakët e hapura duhet të shfaqen qartë në këto zona.

- **Siguria**

Për të minimizuar rrezikun e zjarrit ose shpërthimit, merrni masat e duhura preventive për të parandaluar hyrjen e pakontrolluar ose të paautorizuar, duke përfshirë shkeljen e zonës me potencial të ndezshëm. Ruajuni nga mundësia e manipulimit, vandalizmit dhe zjarrvënies. Masat e sigurisë, duke përfshirë CCTV, alarme, patrulla sigurie etj., mund të jenë të përshtatshme.

- **Veçimi**

Lëngjet e ndezshme duhet të mbahen larg materialeve të tjera të ndezshme dhe të vlefshme dhe zonave të personelit (p.sh. materialet e paketimit, produktet e përfunduara ose zyrat. Kjo do të minimizojë përshkallëzimin e zjarrit/shpërthimit.



Masat zbutëse

Masat zbutëse janë masat që merren kur ndodh një incident për të kufizuar shtrirjen dhe efektin e tij.

- **Ndarja**

Zonat e punës ku trajtohen lëngje të ndezshme normalisht duhet të ndahen nga depot e ndjeshme dhe zonat e drejtuara nga ndarëse që rezistojnë zjarrin. Kujdesuni që ndarjet të jenë të përshtatshme, të mos kufizojnë rrugët e emergjencës ose daljet. Pasi të ketë mbaruar puna, inspektoni zonën për pak kohë për të siguruar që nuk është i pranishëm asnjë material që tymon.



- **Pajisjet Mbrojtëse Personale (PMP)**

Pajisjet e përshtatshme mbrojtëse personale dhe të frymëmarrjes (PMP dhe PMF) nuk duhet të zëvendësojnë sigurimin e kontrolleve të duhura dhe masave të sigurisë në vendin e punës. Qëllimi i PMP/PMF është të adresojnë çdo rrezik të mbetur pasi të jenë zbatuar të gjitha masat e duhura të kontrollit dhe sigurisë.



Masat e Përgjithshme të Sigurisë

Këto kanë për qëllim të sigurojnë që mjediset dhe proceset e vendit të punës të projektohen, ndërtohen dhe mirëmbahen për të zvogëluar rreziqet që vijnë nga substancat e rrezikshme (p.sh. lëngu i ndezshëm) aty ku është e mundur.

- **Projektimi dhe Zbulimi**

Dizajni i vendit të punës dhe mënyra e funksionimit të tij duhet të minimizojnë rrezikun e derdhjes ose lirimit të avullit të lëngut të ndezshëm dhe ndezjen të tij. Përdorni detektorë të lëvizshëm ose të fiksuar për të zbuluar avujt.

- **Modifikimet**

Shumë incidente që përfshijnë lëngje të ndezshme ndodhin gjatë modifikimit të vendit të punës. Shanset rriten nëse puna bëhet nga kontraktorë me pak njohuri për rreziqet e lëngjeve të ndezshme.

- **Pastrimi dhe mirëmbajtja**

Kini kujdes kur përdorni lëngje të tretshme të ndezshme për pastrimin e makinerive, pajisjeve ose artikujve, veçanërisht me metodat manuale. Përdorni lëngje jo të ndezshme, ose lëngje me një pikë të lartë të ndezjes. Shmangni përdorimin e depozitave të hapura ose kontejnerëve të lëngjeve të paqëndrueshëm për futjen e komponentëve, etj. Komponentët e mëdhenj duhet të pastrohen në stacione pastrimi posaçërisht të dizajnuara. Kontejnerët e zbrazët duhet të kthehen në dyqanin përkatës. Kontejnerët në vendin e punës duhet të jenë sa më të vegjël që është e mundur; të jenë të rezistueshëm ndaj goditjeve; të jenë në gjendje të përballojnë dëmtimin dhe konsumimin për përdorim normal dhe t'i rezistojnë veprimit kimik nga përmbajtja e tyre. Përdorni djepa ose karroca të përshtatshme për trajtimin e cisternave dhe kontejnerëve të tjerë të mëdhenj për të minimizuar rrezikun e derdhjeve. Gjatë transportit, kontejnerët duhet të sigurohen.

- **Kontrolli i Derdhjeve**

Merruni me derdhjet dhe rrjedhjet menjëherë. Përdorni pajisjet për thithjen e substancave të derdhura. Zakonisht, për derdhjet e vogla, ato duhet të përmbajnë materiale absorbuese inerte për të thithur derdhjen e cila më pas mund të shtrydhet në një enë metalike dhe të hiqet. Për derdhje më të mëdha, mund të jenë të nevojshme rrethoja ose mure të përkohshme për të përmbajtur derdhjen. Lëngjet viskoze si bojërat derdhen ngadalë në krahasim me tretësit e holluar.



Kushdo që pritet të merret me një derdhje duhet të ketë trajnimin e duhur. Mund të jetë e këshillueshme që të thirrni shërbimin e zjarrfikësve dhe të shpëtimit si një masë preventive. Vendosni lecat e pastrimit dhe sendet e tjera të ndotura me lëng të ndezshëm në një kosh metalik, të etiketuar në mënyrë të përshtatshme dhe të pajisur me një kapak metalik që mbyllet vetë. Zbrazni koshat të paktën çdo ditë pasi paraqesin rrezik zjarri.

- **Asgjësimi**

Mbetjet e lëngshme zakonisht duhet të ruhen dhe trajtohen në përputhje me të njëjtat standarde si lëngjet e ndezshme prej të cilave ato kanë rrjedhur. Asnjëherë mos vendosni mbetje të lëngshme në kanalizimin publik ose rrjedhat e ujit. Mos përzieni materialet e mbetura të ndezshme nga vende të ndryshme të punës para se t'i hidhni, përveç nëse dihen që përbërësit e ndryshëm janë kompatibil. Çdo cisternë që përdoret për materialet e mbetura nuk duhet të përmbajë mbetje që janë jo kompatibile. Kur nuk janë në përdorim, kontejnerët e mbetjeve të lëngshme duhet të mbyllën në mënyrë të sigurt dhe të kthehen në depon e caktuar.



Procedurat Emergjente

Qëllimi i procedurave të emergjencës është të lejojnë kontrollin ose frenimin e një incidenti për t'u dhënë kohë të mjaftueshme njerëzve që të shpëtojnë në një vend të sigurt dhe rrjedhimisht ta bëjnë gjendjen më të sigurt. Përdorni vlerësimin tuaj të rrezikut për të krijuar aranzhime të reagimit emergjent të cilat marrin në konsideratë gjasat, shkallën dhe efektet. Rrugët e komunikimit duhet të përcaktohen paraprakisht gjatë emergjencës. Planifikoni paraprakisht ndihmën e parë dhe kujdesin mjekësor.

- **Rrjedhjet dhe derdhjet**

Veprimi i shpejtë për të trajtuar rrjedhjet mund të parandalojë përshkallëzimin në një incident më të madh, përfshirë zjarrin. Faqja e të Dhënave të Sigurisë së Materialit (FDSM) e furnitorit duhet të detajojë çdo veprim specifik që duhet ndërmarrë për trajtimin e derdhjeve.

- **Pajisje për shuarjen e zjarrit**

Këto mund të jenë aparate për fikjen e zjarrit dhe/ose e zorrë uji për të trajtuar një zjarr në fazat e tij fillestare, ose sisteme tjera për të gjuajtur ujë ftohës mbi kontejnerët. Rekomandohet që, sipas vlerësimit të rrezikut, një dispozitë e tillë të diskutohet me autoritetin tuaj lokal për zjarr fikje dhe shpëtim. Çfarëdo pajisje për zjarr fikje që të sigurohet, sigurohuni që njerëzit të cilët pritet ta përdorin atë të trajnohen.

- **Informimi dhe Trajnimi**

Trajnimi i duhur dhe njohuria për vetitë e lëngjeve të ndezshme të pranishme në vendpunishte janë thelbësore për trajtimin e tyre të sigurt dhe përdorimin e procedurave të emergjencës. Trajnimi duhet të përfshijë Vlerësimin e Rrezikut në lidhje me llojet e lëngut të ndezshëm që trajtohet, vendndodhjen, vetitë dhe rreziqet e tyre, procedurat e përgjithshme për trajtim të sigurt, përdorimi i PMP-ve, mirëmbajtja, raportimi i defekteve dhe incidenteve (p.sh., derdhjet), dhe procedurat e emergjencës, duke përfshirë aktivizimin e alarmit. Mbani një regjistër për një trajnim të tillë.

- **Sinjalizimi dhe etiketimi**

Vendosni shenja të përshtatshme të sigurisë duke përfshirë etiketimin e kontejnerëve me lëng të ndezshëm. Vlerësimi i riskut do t'ju ndihmojë të përcaktoni natyrën dhe shkallën e shenjave të sigurisë që kërkohen.

- **Shpërndarja dhe kullimi në shkallë të vogël**

Shpërndarja dhe kullimi duhet të kryhen në atë mënyrë që redukton derdhjet dhe lirimet e rrezikshme të avujve të ndezshëm. Kontejnerë të vegjël sigurie nga metali ose plastika e fortë janë në dispozicion të tilla si me vrime të derdhjes dhe/ose mbushjes, të mbyllura me kapakë vetëmbyllës në formë sustash, me vrime të derdhjes dhe/ose mbushjes të pajisura me ndërprerës të flakës, zorrë uji ose mjete të tjera ndihmëse kur intervenohet përmes hapësirave të ngushta, doreza mbajtëse për kontejnerë me kapacitet më të madh se afërsisht 2.5 litra. Përdorni hidrantët e sigurisë me ventil të presionit. Përdorni pompa të vogla manuale portative.





FAQET E TË DHËNAVE TË E SIGURISË SË MATERIALIT (FDSM)

FDSM duhet të jetë e pranishme në vendin e punës në mënyrë që punëtorët të jenë të familjarizuar me të. Ata duhet të ndërmarrin veprime të duhura operationale dhe emergjente gjatë përdorimit dhe ruajtjes së lëngjeve të tilla.

Një FDSM standarde ka 16 elemente në të, duke përfshirë vetitë kimike dhe fizike, ndihmën e parë, përgjigjen ndaj emergjencës, udhëzimet për mjedisin dhe asgjësimin, etj.



DEPONIMI I LICENCUAR

Deponimi i lëngjeve të ndezshme përtej një sasive të caktuar është i rregulluar sipas kornizës ligjore në fuqi. Për më shumë, ju lutem përmbajuni dhe respektoni Ligjet e Republikës së Kosovës.

AUDITIMET

Punëdhënësi duhet të ketë auditime të brendshme/vetë-inspektime sipas listës së sugjeruar të Shtojcës. Kjo do t'u mundësojë atyre që të menaxhojnë në mënyrë efektive Shëndetin dhe Sigurinë dhe gjithashtu t'i përgatisë ata për çdo auditim të jashtëm siç janë Rregullatori (Inspektorati i Punës, etj.) dhe Certifikimi, nëse ka të tilla.



VËREJTJET PËRFUNDIMTARE

Mbani mend: Avujt nga lëngu i ndezshëm formojnë një burim të padukshëm të rreziqeve nga zjarri dhe shpërthimi. Sidoqoftë, mos u shqetësoni! Ju mund ta menaxhoni rrezikun duke ndjekur udhëzimet e parashtruara në këtë Udhëzues.

Për më shumë informata, kontaktoni Inspektoratin e Punës.



SHTOJCA

Pyetjet e Auditimit të Punëdhënësit për Përdorimin dhe Trajtimin e Sigurt të Lëngjeve të Ndezshme (Udhëzuesi), siç janë marrë nga dokumenti i listës së kontrollit të konsoliduar të Auditimit të SSHP-së të BE-së të zhvilluar në mars të vitit 2021, janë dhënë më poshtë.

U referohen seksioneve:

2.2.5 Pluhuri dhe agjentët kimikë (atmosfera shpërthyes)

2.6.7 Rreziqet që lidhen me aksidentet në punë (mbrojtja nga zjarri)

1. A janë identifikuar të gjitha zonat në të cilat mund të jetë e pranishme një atmosferë shpërthyes gazi, në sasi të tilla që kërkojnë masa të veçanta preventive?
2. A janë identifikuar të gjitha zonat në të cilat mund të ruhen, prodhohen ose trajtohen eksplozivët?
3. A ka ndonjë diagram ose sinjalistikë zone që tregon qartë përmasën dhe natyrën e rrezikut në tri dimensione?
4. A e ka i gjithë personeli që punon në ose afër rrezikut vetëdijen dhe/ose trajnimin e duhur në lidhje me zonat e rrezikshme?
5. A është ventilimi i mjaftueshëm për të siguruar një shikim të mirë të operatorit, për të parandaluar vendosjen dhe grumbullimin e pluhurit/avullit të ndezshëm në dhomë, për të zvogëluar përqendrimet e pluhurit/avullit të ndezshëm, për të parandaluar rrjedhjen e ndotësve në zonat e afërta të punës ose në mjedis?
6. A ekzistojnë mënyra pastrimi për të minimizuar retë e pluhurit/avullit të ndezshëm, veçanërisht kur janë të pranishme burimet e ndezjes?
7. A janë të lidhura dhe tokëzuara të gjitha makineritë që krijojnë pluhur apo sistemet e tubacioneve të avullit të ndezshme dhe mbledhësit e pluhurit, për të reduktuar akumulimin e ngarkesave elektrike statike?
8. A lejohet pirja e duhanit vetëm në zona të caktuara të sigurta? A janë zonat ku pirja e duhanit është e ndaluar të shënuara qartë me shenja "Ndalohet pirja e duhanit"?
9. A janë vendosur shenjat e sigurisë (shenja paralajmëruese, shenja të detyrueshme) në përputhje me vlerësimin e rrezikut në vendin e punës?
10. A janë në dispozicion dhe të shënuara objektet e ndihmës së parë?
11. A përfshihen proceset e emetimit të pluhurit dhe avullit në vlerësimin e rrezikut në vendin e punës?
12. A merren masa për të reduktuar dhe parandaluar rreziqet e një atmosfere shpërthyes?
13. A përdoret sistemi i zbulimit të shkëndijave dhe shtypjes së shpërthimit në sistemin e mbledhjes së pluhurit/zonën e avullit të ndezshëm (ose ndonjë masë të ngjashme preventive)?
14. A përfshinë programi i trajnimit temat si ndikimin në shëndet, kontrollet, metodat e sigurta të punës dhe pajisjet/veshjet mbrojtëse personale?
15. A janë marrë masat e mbrojtjes nga zjarri në përputhje me planin e mbrojtjes nga zjarri?
16. A është bërë një vlerësim i rrezikut në vendin e punës dhe a janë përfshirë rreziqet e zjarrit?
17. A funksionojnë mirë pajisjet e vendosura të destinuara për alarm dhe shuarje të zjarrit, zbulimi të gazrave dhe avujve të ndezshëm, si dhe pajisjet dhe instalimet e tjera mbrojtëse që shërbejnë për të parandaluar shkaktimin dhe përhapjen e zjarrit dhe shpërthimeve?